



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:217258
Datë: 11.12.2024
Numri i dokumentit: 06580635

K.DH.SH.II.nr.403/23

GJYKATA KOMERCIALE – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha në çështjen juridike përmbare të kreditorit “Alijaj Group” shpk, me seli në Bajram Curr Republika e Shqipërisë, ndaj debitorit “Tim Invest Group” shpk (Fabrika e kromit) me seli ne fshatin Vugovë Komuna Gjakovë, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e personit të tretë B.A.R, e ushtruar përmes te autorizuarit Muhamet Binaku avokat, kundër parregullsive te Organit Përmbareues “Nato-Law” me Përmbareues Privat Jeton Krasniqi me rastin e nxjerrjes se Konkluzionit për Ngarkim te barrës juridike në paluajtshmëri P.nr.181/2019 dt.08.03.2021, me datën 11.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET POSHTË si e palejuar ankesa e personit të tretë B.A.R., e ushtruar përmes të autorizuarit avokat Muhamet Binaku, kundër parregullsive te Organit Përmbareues “Nato-Law” me Përmbareues Privat Jeton Krasniqi , me rastin e nxjerrjes së Konkluzionit për Ngarkim te Barrës Juridike në Paluajtshmëri, P.nr.181/2019 datës 08.03.2021.

A r s y e t i m

Zyra Përmbareme “Nato-Law” me Përmbareues Privat Jeton Krasniqi, me Konkluzionin P.nr.181/2019 dt.08.03.2021 për Ngarkim te barrës juridike në paluajtshmëri ka kërkuar nga Drejtoria e Kadastrit ne Fushë Kosovë, ti vihet barra juridike: E drejta e pengut te fituar ne pronën e paluajtshme P-72514011-00495-10, me sipërfaqe prej 1573 m² e evidentuar ne

Agjencinë e Kadastrit në emër të pronarit përkatësisht debitorit –borxhliut ‘Tim “Invest Group” shpk, me adresë në fshatin Rogovë Komuna e Gjakovës dhe kjo përmes shënimit të barrës juridike, ti regjistrohet kësaj prone ngarkesa si me lartë, sipas dispozitave LPP-së.

Kundër këtij Konkluzioni, pala e tretë B.A.R., përmes të autorizuarit avokat Muhamet Binaku, ka ushtruar ankesë kundër parregullsive të Organit Përmbaues “Nato-Law” me Përmbaues Privat Jeton Krasniqi, përmes së cilës ka propozuar që Gjykata e shkallës së dytë ta urdhëroj Përmbauesin Privat Jeton Krasniqi që ta përmirësoi Konkluzionin e nxjerr me dt.08.03.2021 me nr.P.181/2019, dhe ta bënë deblokimin e Barrës Juridike të pronës së paluajtshme të evidentuar P-72514011-00495-10 në Zonën Kadastrale në Vragoli e quajtur “Vakuf Kod Quprije”, me sipërfaqe prej 1,573 m² në emër të personit fizik B.A.R..

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, Konkluzionin për Ngarkim të Barrës Juridike në Paluajtshmëri P.nr.181/2019 dt.08.03.2021, ankesën kundër parregullsive të Organit Përmbaues “Nato-Law” me përmbaues Jeton Krasniqi, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e palës së tretë B.A.R., është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Alijaj Group” shpk, me seli në Bajram Curr Republika e Shqipërisë, me datën 19.04.2019 ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit “Tim Invest Group” shpk (Fabrika e kromit) me seli në fsh. Vugovë K. Gjakovë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave të listuara si në propozimin për përmbarim. Përmbauesi Privat Jeton Krasniqi për territorin e Gjykatës Themelore në Pejë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me urdhrin përmbaorimor P.nr.181/19 të datës 23.04.2019, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që në emër të kompensimit të borxhit për furnizimet me krom të varfëruar, ti paguaj kreditorit shumën prej 121,081.00 USD si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 487 euro.

Kundër këtij urdhri me datën 22.05.2019, debitori ka ushtruar prapësim, për te cilin ka vendosur Gjykata Themelore ne Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin PPP.nr.172/19 dt.06.12.2019, me te cilin e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa sipas ankesës ndaj këtij aktvendimi ka vendosur Gjykata e Apelit AC.nr.812/2020 dt. 21.09.2020 me te cilën e ka refuzuar ankesën e debitorit ndërsa aktvendimin e atakuar te shkalles se parë e ka vërtetuar.

Organi Përmbaues me Përmbaues Privat Jeton Krasniqi ka vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve përmbaimore dhe me këtë edhe nxjerrjen e Konkluzionit P.nr.181/2019 dt.08.03.2021 për Ngarkim te barrës juridike ne paluajtshmëri.

Ndaj këtij Konkluzioni ka ushtruar ankesë personi i tretë B.A.R përmes përfaqësuesit te autorizuar avokat Muhamet Binaku, me të cilën ka kërkuar që paluajtshmërisë P-72514011-00495-10 e evidentuar ne emër te Tim Invest Group shpk, me adresë me adresë ne fshatin Rogovë Komuna Gjakovë ti vihet barra e juridike E drejta e Pengut te Fituar.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, duke vlerësuar lejueshmërinë e ankesës së paraqitur kundër parregullsive te Organit Përmbaues “Nato-Law” me Përmbaues Jeton Krasniqi përkitazi nxjerrjes së Konkluzionit për Ngarkim te Barrës Juridike ne Paluajtshmëri P.nr.181/2019 dt.08.03.202, bazohet ne nenin 79 par.1 te LPP i cili parasheh qe *“Pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë mund të parashtrorjë një ankesë në Gjykatë, lidhur me parregullsitë që janë kryer nga organi përmbaues gjatë kryerjes së procedurës së përmbaimit. Kjo kërkesë i bëhet Gjykatës me një parashtrorë me shkrim në afat prej shtatë (7) ditësh nda dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar”* dhe par.3 i këtij neni i cili parasheh qe *“Palët ose pjesëmarrësit tjerë në procedurë kanë të drejtë ankese kundër vendimit të përmendur në paragrafin 2. të këtij neni në pajtim me dispozitat e nenit 77 të këtij ligji”*. Ne rastin konkret gjykata e shkallës së dyte konsideron se është jo kompetente për ta trajtuar këtë ankesë, pasi e kompetencës lëndore është gjykata e shkallës së parë. Përkitazi kësaj çështje kjo gjykatë vlerëson nenin 79 par.2 te LPP-së, e kjo ne lidhshmëri me nenin 77 par.2 te LPP i cili decidivisht parasheh që: *“Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrorhet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit”*, gjë që në rastin konkret ankesa kundër parregullsive te organit përmbaues ka qenë dashur te

drejtohet në shkallën e parë . Prandaj bazuar në këtë gjendje faktike dhe ligjore, kjo gjykatë vlerëson nenin 209 pika a) e LPK-së e cila parasheh që” Gjykata e shkallës së dytë “*mund ta hedh ankesën si jo te kohëshme, jo te plotë apo jo te lejueshme*” për çka edhe vendosi që ankesën e parashtruar ta hedhë poshtë si të palejuar.

Nga arsyet e lartcekurat, në pajtim me dispozitën e nenit 208 e lidhur me nenin 209 pika (a) të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.403/23 me datë 11.12.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha